



Datë: 03.12.2025
Numër protokolli: 2035/2025

A.nr.294/2024

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Avdyll Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1632/2022 të datës 20.02.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin A.A.mr.355/2024 të datës 10.10.2025 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.337/2022 të datës 06.04.2022 të parashtruar nga ankuesit A.B, I.M, F.K, K.R, H.P dhe A.SH, të cilët me autorizim i përfaqëson Avokat Avni Thaqi, nga Prizrenit kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.337/2022 të datës 06.04.2022 të parashtruar nga ankuesit A.B, I.M, F.K, K.R, H.P dhe A.SH, ashtu që **detyrohet** Drejtori i Divizionit për Personel dhe Administratë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit, duke shqyrtuar kërkesën e datës 04.03.2022 të parashtruar nga ankuesit, dhe të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ankuesit: A.B sipas kontratës me numër reference 07/1-01A/0363 të datës 16.05.2005 në pozitën “Radiokomunikues dhe baza e të dhënave” në Stacionin Policor-Sektorin e Operativës në Prizren, I. M sipas kontratës me numër reference 7/1-01A/0361 të datës 16.05.2005 në pozitën “Shef i administratës dhe personelit” në Stacionin Policor-Sektorin e Resurseve në Prizren, F.K sipas kontratës me numër 07/1-

01A/0357 të datës 16.08.2005 në pozitën “Zyrtar në Mto dhe Logjistikë” në Stacionin Policor-Zyra për Shërbime Mbështetëse në Prizren, F.M sipas kontratës me numër reference 07/1-01A/0395 të datës 26.01.2004 në pozitën “Radiokomunikues dhe baza e të dhënave” në Stacionin Policor-Sektorin e Operativës në Prizren, , K.R sipas kontratës me numër reference 07/1-01A/0354 të datës 16.05.2005 në pozitën “Nëpunës” në Stacionin Policor ne Prizren, H.P sipas kontratës me numër reference 07/1-01A/0362 të datës 16.05.2005 në pozitën “Zyrtar në bazën e të dhënave” në Stacionin Policor-Sektori i Operativës – Zyra e SIPK-ut dhe A.Sh sipas kontratës me numër reference 07/1-01A/1504 të datës 26.09.2005 në pozitën “Udhëheqës i Njësisë për shërbime Mbështetëse” në Stacionin Policor-Sektori Rajonal për Resurse, Njësia për Shërbime Mbështetëse në Gjakovë të punësuar në Policinë e Kosovës, me datën 04.03.2022, përmes përfaqësuesit të autorizuar kanë parashtruar kërkesë/ankesë për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Policinë e Kosovës, lidhur me harmonizimin e koeficienteve dhe kompensimin e pagesës adekuate që nga data 02.11.2015.

Me datën 29.03.2022, Drejtori i Divizionit për Personel dhe Administratë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, ka kthyer përgjigjen sipas të cilës ankuesit janë njoftuar se koeficientet janë përcaktuar nga DMZP (ish MAP) dhe të njëjtit vazhdojnë të marrin pagën konform koeficienteve të tyre, gjithashtu ky institucion i ka njoftuar ankuesit se përshkrimi i detyrave të punës është hartuar në pajtim me katalogun e përshkrimit të detyrave dhe rregulloren për klasifikim të vendeve të punës (në të kaluarën) dhe me pas këto pozita janë dorëzuar në DMZP (ish MAP) për aprovim të klasifikimit të vendeve të punës por që deri me tani Policia e Kosovës nuk ka pasur aprovim të klasifikimit të vendeve të punës për shërbyes civil.

Të pakënaqur me përgjigjen e Policisë së Kosovës konform kërkesës së datës 04.03.2022, ankuesit përmes përfaqësuesit të tyre, me datën 06.04.2022, kanë parashtruar ankesën më numër protokollit 1908/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me harmonizimin e koeficienteve të ankuesve me pozitat e tyre si dhe kompensimin e pagesës adekuate nga datat e precizuara në kërkesat personale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datën 14.04.2022, ankesën e ankuesve e ka proceduar për përgjigje në ankesë te Policia e Kosovës. Policia e Kosovës me datën 11.05.2022 ka përcjell shkresat lidhur me dokumentacionin e kërkuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.05.2022, ka nxjerr Vendimin A.nr.337/2022, me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesve, ndërsa ankuesit kundër këtij vendimin kanë iniciuar konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, më datë 20.02.2024 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1631/2022 , me të cilin ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve duke anuluar Vendimin A.nr.337/2022 dhe duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje. Kundër këtij aktgjykimi, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.03.2024 ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, me Aktgjykimin A.A.nr.355/2024 të datës 10.10.2025 ka refuzuar ankesën duke e vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) në lidhje me këtë ankesë administroi këto prova: Ankesën me Nr. Prot: 1908/2022 të datës 06.04.2022 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetimin mbi pranimin e dërgesës të datës 05.03.2022 nga Posta e Kosovës; Prova shtesë nga përfaqësuesi ligjor i ankuesve të datës 17.05.2022; Autorizimin e datës 30.03.2022 lidhur me nënshkrimet e ankuesve për përfaqësuesin ligjor të tyre; Vendimin me numër 1127 të datës 28.10.2010 nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 11.05.2022 nga Policia e Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me numër të referencës 07/1-01A/0363 të datës 16.05.2005 për ankuesin A.B; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me numër të referencës 07/1-01A/0361 të datës 16.05.2005 për ankuesin I. M; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me numër të referencës 07/1-01A/0357 të datës 16.05.2005 për ankuesin F.K; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me numër të referencës 07/1-01A/0395 të datës 26.01.2004 për ankuesin F.M; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me numër të referencës 07/1-01A/0354 të datës 16.05.2005 për ankuesin K.R; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me numër të referencës 07/1-01A/0362 të datës 16.05.2005 për ankuesin H.P; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me numër të referencës 07/1-01A/1504 të datës 26.09.2005 për ankuesin A.Sh; Kërkesat e ankuesve të datës 04.03.2022 përmes përfaqësuesit të tyre të parashtruara në Policinë e Kosovës; Përgjigjen e datës 29.03.2022 nga Policia e Kosovës në kërkesat e ankuesve; Emailin zyrtar të datës 18.05.2022 lidhur me provat shtese për Listat e pagave për ankuesit për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor për vitet 2020, 2021 si dhe muajt janar, shkurt dhe mars të vitit 2022 si dhe e-mailin zyrtar të datës 17.05.2022 lidhur me kërkesën për prova shtesë.

Kolegji i Këshillit, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesve, është e bazuar, ashtu që detyrohet Drejtori i Divizionit për Personel dhe Administratë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, të shqyrtoj kërkesën/ankesën e datës 04.03.2022 të ankuesve, *sepse*:

Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh vërejtjet e dhëna nga gjykata sikurse në Aktgjykimin A.nr.1632/2022 të datës 20.02.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin A.A.mr.355/2024 të datës 10.10.2025 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamentit për Çështje Administrative, thekson faktin se ankuesit në këtë rast ,ankuesit më datë 04.03.2022, përmes përfaqësuesit të autorizuar kanë parashtruar kërkesë/ankesë për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Policinë e Kosovës, lidhur me harmonizimin e koeficienteve dhe kompensimin e pagesës adekuate që nga data 02.11.2015, ndërsa lidhur me këtë Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Policisë së Kosovës, nuk kishte shqyrtuar këtë rast, gjegjësisht lidhur me kërkesën/ankesën e ankuesve të datës 04.30.2022, ishte përgjigjur Drejtori i Drejtorisë për Personelit dhe Administratë në Policinë e Kosovës i cili përmes përgjigjes së datës 29.03.2022, kishte njoftuar ankuesit se koeficienti i pagës është përcaktuar nga DMZ ish MAP.

Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh faktin se ankuesit nga organi përkatës i punësimit nuk kanë marr ndonjë përgjigje konkrete e cila do të shqyrtonte në tersi pretendimet e tyre të ngritura përmes kërkesës/ankesës së datës 04.03.2022, në këtë rast ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje referuar: LPPA), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: 2. *Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative*, nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure*. 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes*, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me Kërkesën 04.08.2025 të parashtruar nga ankuesja, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të nxjerr akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, heshtja e organit të administratës, në këtë rast, Drejtori i Divizionit për Personel dhe Administratë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës në raport me kërkesën e datës 04.03.2022, cenon të drejtat e ankuesve në kuptimin e të drejtave procedurale dhe për rrjedhojë edhe vendosjes në mënyrë meritore, ngase ashtu sikurse është thënë në arsyetim të këtij vendimi, në kërkesën e parashtruar të organi i punësimit, ankuesit pretendojnë realizimin e të drejtës lidhur me pagën.

Kështu që, thënë si me sipër e duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar në kuptim të shkeljeve procedurale, dhe si rrjedhojë detyroj Drejtori i Divizionit për Personel dhe Administratë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, që në respektim të dispozitave procedurale të shqyrtoj kërkesën e ankuesve të datës 04.03.2022 dhe të nxjerr akt administrativ në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Prandaj, Drejtori i Divizionit për Personel dhe Administratë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, me rastin e vendimmarrjes karshi kërkesës/ankesës së datës 04.03.2022 të ankuesve, palët e pakënaqura kundër vendimit t'i udhëzoj sipas dispozitave të Legjislacionit përkatës dhe akteve të tjera të brendshme të Policisë së Kosovës lidhur me marrëdhënien e punës së të punësuarve në kuadër të këtij institucioni.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.294/2024, datë 03/12/2025.

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve, Av.Avni Thaqi;
- Kreshnik Kaçiu, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative;
- Drejtori i Divizionit për Personel dhe Administratë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.